



Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë në suaza të jetësimit ekzistues të projektit “Mbështetja e punësimit për të rinjtë, të papunët afatgjatë dhe gratë” (II), i financuar nga BE-ja, bën

SHPALLJE PUBLIKE

për personat e papunë për pjesëmarrje në Stërviçet e avancimit të shkathtësive IT

Të gjithë të papunët që janë të regjistruar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë si kërkues aktiv të punës, u bëhet thirrje të aplikojnë për pjesëmarrje në njërin nga stërviçet për shkathtësi IT siç vijojnë.

- JAVA Programmer SE7 Training (për 47 pjesëmarrës) dhe
- MCSD: Web Applications Programme Trainings (për 47 pjesëmarrës).

Këto stërviçe do ta rrisim punësueshmërinë e 94 personave dhe do të sigurojnë mundësi për rritjen e aftësive profesionale dhe fitimin e kualifikimeve për vendet e caktuara të punës të cilat janë të kërkuara në tregun e punës.

Stërviçet për avancimin e shkathtësive IT do të realizohen nga ana e provajderëve të zgjedhur stërviçës në mbarë territorin e shtetit.

o Kriteret e zgjedhjes

Kandidatët e interesuar mund të plotësojnë formularin e pjesëmarrjes, me qëllim që të marrin pjesë në njërin nga stërviçet e lartpërmendura të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë dhe në ndonjë qendër vendore të punësimit në mbarë shtetin.

Po ashtu, personat e papunëdo të parapërzgjidhen nga regjistri i kërkuesve aktiv të punës në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, në përputhje me planin e tyre individual të punësimit (PIP). Personat e parapërzgjedhur do të ftohen (me SMS ose email) në qendrat e punësimit për ta plotësuar aplikimin e pjesëmarrjes dhe të zgjedhin stërviçin për avancimin e shkathtësive IT për të cilën janë të interesuar më së shumti.

Secili kandidat duhet t'i plotësojë kriteret siç vijojnë:

- Të papunët të regjistruar si të papunë në Agjencien e Punësimit të Republikës së Maqedonisë;
- Deklaratë në Planin individual të punësimit (DPIP) se personi i papunë dëshiron të marrë pjesë në stërviçet e avancuara për shkathtësi IT;
- Me arsim të mesëm ose të lartë;
- Përgatitje adekuate profesionale varësisht nga lloji i stërviçes.





Përzgjedhja përfundimtare e pjesëmarrësve në stërvitje do të bëhet nga ana e Komisionit të Evoluimit në bazë të kriterëve të përmendura më lart, me një listë ranguese të përgatitur me të gjithë kandidatët e interesuar.

Në qoftë se numri i kandidatëve të interesuar e tejkalon atë që ka qënë planifikuar, atëherë si kriter për zgjedhje do të merret periodha kohore e papunësisë së regjistruar.

Gjatë rrjedhës së procedurës përzgjedhëse të kandidatëve, Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë do t'i zbatojë parimet siç vijojnë:

- Kandidatët të cilët tanimë kanë marrë pjesë në stërvitjet për avancimin e shkathtësive IT nuk mund të përfshihen sërish në stërvitje;
- Në qoftë se numri i kandidatëve të interesuar e tejkalon atë të planifikuar, atëherë si kriter përzgjedhës do të merret gjatësia e periudhës së papunësisë së regjistruar;
- Në qoftë se kandidatët kanë arsimim të ngjashëm me atë për të cilën mbahet stërvitja, atëherë kjo do të merret si përparësi gjatë përzgjedhjes;
- Në qoftë se numri i kandidatëve të përshtatshëm është më i madh se numri i paraparë i pjesëmarrësve në stërvitje, atëherë kandidatët do të zgjidhen sipas klasifikimit në listën ranguese të kandidatëve;
- Kandidatët që i plotësojnë kriteret, do të dërgohen te organizatorët e stërvitjes për paratestim dhe vetëm ata që do ta japin paratestimin do të mund të marrin pjesë në stërvitje. Lista përfundimtare e kandidatëve dhe rezultatet e arritura nga paratestimi, do të jenë në dispozicion në ueb faqen e Agjencisë së Punësimit të Republikës së Maqedonisë, si dhe në qendrat e punësimit brenda shtetit;

Kandidatët të cilët deri tani nuk kanë marrë pjesë në stërvitja të këtilla inkurajohen që të paraqiten për pjesëmarrje.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë i inkurajon të gjithë personat e papunë të përkatësive të ndryshme gjinore, nacionale dhe kulturore që të aplikojnë me qëllim që të fitojnë aftësi relevante për profesionet specifike të kërkuara në tregun e punës. Personat nga grupet e pakicave dhe personat me nevoja të posaçme inkurajohen që të paraqiten.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë e ruan të drejtën për t'i refuzuar kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme.

○ Realizimi i stërvitjeve

Stërvitjet do të mbahen në një periudhë prej gjashtë muajsh duke përfshirë ligjëratat, orët përgatitore për provim dhe provimin e marrjes së certifikatës.

Secili nga personat e papunë që zgjidhet për të marrë pjesë në stërvitje do të nënshkruajë deklaratë për pjesëmarrje në stërvitje për të cilën ka aplikuar paraprakisht.





**Support to the Employment of Young People,
Long-Term Unemployed and Women (II)**

This project is funded by the European Union



Pjesëmarrësit e stërvitjes të cilët do të arrijnë së paku 70 për qind pjesëmarrje në stërvitje do të mund ta japin provimin për marrjen e certifikatës ndërkombëtare.

Dhënia e provimit për marrjen e certifikatës ndërkombëtare do të mbahet në një periudhë prej tre muajsh pas mbarimit të pjesës teorike të stërvitjes dhe atyre për përgatitjen e dhënies së provimit.

○ **Procedura e aplikimit**

Personat e papunë që janë të interesuar, si dhe që janë të regjistruar si kërkues aktiv të punës, mund të dorëzojnë aplikim për pjesëmarrje në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë dhe në ndonjërin prej 30 qendrave të punësimit brenda shtetit, duke e shprehur interesimin e tyre për pjesëmarrje në stërvitjet për avancimin e shkthatesive IT, duke e theksuar tipin e stërvitjes, çdo ditë pune prej orës 8:30 deri 16:30.

Shpallje publike do të botohet në ueb faqet siç vijojnë:

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë www.avrm.gov.mk

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale www.mtsp.gov.mk

Secila informatë e përfshirë në aplikacion do të trajtohet në mënyrë sekrete.

Projekti “Mbështetja për punësimin e të rinjve, të papunëve afatgjatë dhe grave” (II) është financuar nga në suaza të Planit operativ të programeve për “Zhvillimin e urimeve njerëzore 2007-2013) (Komponenti IPA IV). Aktivitetet e projektit ndihmojnë drejtpërdrejt në arritjen e qëllimit të Planit Operativ të masave aktive në tregun e punës gjatë vitit 2016.

